

Pledge by the Secretary General of the Regional Cooperation Council (RCC) Majlinda Bregu at the International Donors' Conference "Together for Albania" in Brussels today

News in English further in the text

E nderuar Presidente e Komisionit European,
Të nderuar Komisionerë,
Kryeministra,
Ministra dhe Kolegë,

- Më sa duket jam e vetmja shqiptare sot këtu që drejtoj një Organizatë Ndërkombëtare dhe do më duhet të shpreh mbështetjen financiare për tërmetin që goditi vendin tim.
- Ndihem e prekur dhe shumë e emocionuar si shqiptare, nga mbështetja e jashtëzakonshme e treguar këtu sot.
- Tërmeti i nëntorit ishte ndoshta minuta më e gjatë e jetës sime deri më tani. Është e frikshme për një nënë të shohë fëmijët e saj të terrorizuar, por përsëri duhet ta quaj veten me fat që u ndodha në shtëpi dhe të gjithë jemi shëndoshë e mirë.
- Por është e trishtë të dëgjosh dëshmitë e atyre që humbën njerëzit e afërt, apo ata që kanë humbur shtëpitë e përballen me pasigurinë për të ardhmen.
- Gjithsesi është ngushëllim kur në raste fatkeqësish nuk mbetesh vetëm.
- Qeveritë dhe miqtë e rajonit ishin të parët që mbërritën, duke ofruar ndihmë për viktimat, duke na bindur dhe njëherë se dhimbja nuk njeh ndasi e kufij hartash.
- Ndihma s'ka vetëm një formë. Afërsia, empatia, i japin kuptim bashkëpunimit e solidaritetit më shumë se burokracia. Këtë u përpoqëm të bënim nga RCC dhe kjo është ajo që përpiqemi të bëjmë çdo ditë: t'i japim pamjen njerëzore bashkëpunimit.

Ballkani Perëndimor është një rajon i vogël, me rreth 18 milionë banorë, me burime të kufizuara financiare dhe njerëzore.

Kjo është arsyeja pse ne i kemi propozuar vendeve të rajonit që të krijojnë një Ekip Reagimi dhe Vlerësimi të Emergjencave në Ballkanin Perëndimor, si një grup rajonale për reagim dhe vlerësim të shpejtë në raste të katastrofave humanitare. Gjithashtu e ritheksoj gatishmërinë tonë për të mbështetur këto nisma, në interes të stabilitetit rajonal afatgjatë.